



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim letrar në Gjuhën B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 10 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Nëpërmjet këtij kursi studentëve u ofrohet përgatitja profesionale teoriko-analitike për letërsinë dhe përkthimin e saj. Studenti do t’i mësojë ambjentin në të cilin punon përkthyesi letrar, do të njihet me karakteristikat e veçanta të llojeve kryesore të shprehjes letrare, do të përgatitet profesionalisht për të vështirësitë e përkthimit letrar.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të hartojnë paratekset që shoqërojnë tekstet letrare për përkthim;
- 2.Të përkthejnë tekste letrare të vështirësisë mesatare;
- 3.Të krijojnë mendimin e pavarur të përkthimit letrar.

Rezultate të pritshme:

- 1.Shpjegojë konceptet themelore të teorisë së përkthimit letrar, si dhe dallimet ndërmjet përkthimit letrar dhe llojeve të tjera të përkthimit.
- 2.Analizojë tekstin letrar si objekt i përkthimit, duke identifikuar veçoritë stilistike, leksikore dhe kulturore që duhen marrë parasysh në procesin përkthimor.
- 3.Aplikojë teknikat e përkthimit letrar në përkthimin e teksteve të shkurtra nga autorë klasikë dhe bashkëkohorë, nga greqishtja në shqip dhe anasjelltas.
- 4.Zgjedhë strategjinë përkthimore më të përshtatshme në varësi të llojit të tekstit, stilit të autorit dhe synimit komunikues të përkthimit.
- 5.Reflektojë në mënyrë kritike mbi vendimet e marra gjatë përkthimit, duke justifikuar zgjedhjet e veta përmes analizës teorike.